



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivery	16-04-2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtujta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRINSHCK	1836	2021	1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A 221/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar,- Ardita Hxhnikaj-Demi dhe Malsore Gshi-Bajraktari anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.221/2019, të datës 28.03.2019, së ankuesit

si dhe ankesës A. Nr.229/2021, të datës 01.04.2021, sipas Aktgjykimit A. Nr. 2210/2019, të datës 15.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë / Departamenti për Çështje Administrative. me adresë banimi fshati „Lladrovë”, 27, nga Komuna e Malishevës, kundër organit të punësimit Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike “ masë disiplinore ”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 15.04.2021, mori këtë;

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 221/2019 e datës 28.03.2019, e parashtruar nga ankuesi si dhe ankesës A. Nr.229/2021, të datës 01.04.2021, sipas Aktgjykimit Anr.2210/2019, të datës 15.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë / Departamenti për Çështje Administrative.

II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr. 729, i datës 28.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë Pyjore të Kosovës.

A r s y e t i m

Kryeshefi i Agjencisë Pyjore të Kosovës, me datën 04.01.2019, me numër KE -03/2019, i ka shqiptuar masën disiplinore „ Vërejte me shkrim”, për nëpunësin civil

Ankuesi i pakënaqur me vërejtën e datës 04.01.2019, të nxjerr nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës, me datë 28.01.2019, me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave tek Agjencia Pyjore e Kosovës.

Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Agjencisë Pyjore të Kosovës, me datë 28.02.2019, me numër 729, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit, me arsyetimin se si të pa bazuar ne ligj.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër 729, të datës 28.02.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Agjencinë Pyjore të Kosovës, brenda afatit ligjor sipas Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datë 28.03.2019 parashtron ankesë, me pretendimet ankimore lidhur me shqiptimin e vërejtjes me shkrim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Agjencia Pyjore e Kosovës, për përgjigje në ankesë me datë 29.03.2019, ndërsa me datë 04.04.2019 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia Pyjore e Kosovës, me provat e bashkangjitura .

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 30.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, me datë 15.03.2021, me numër A.nr. 2210/2019, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e detyruar që në afatin prej tridhjetë (30) ditës të vendos lidhur me aneksen e ankuesit Xhezair Bibaj.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.221/2019, e datës 28.03.2019, me numër protokoll 1623/2019, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; ankesës A. Nr.229/2021, të datës 01.04.2021, sipas Aktgjykimit A. Nr. 2210/2019, të datës 15.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë / Departamenti për Çështje Administrative. Vërejte me shkrim e datës 04.01.2019; Ankesë e datës 28.01.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 28.02.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Akt Emërimi i datës 31.12.2013; njoftimi i datës 03.09.2019, Këshillit; Formuari i vlerësimit të rezultateve në punë; e-miali i datës 30.04.2019; Përgjigje ne ankesë e datës 04.04.2019, me numër protokoll 1747/2019, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se udhëheqësi më i lartë administrativ i Agjencisë Pyjore të Kosovës, vërejtjen me shkrim e ka bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës, në rastin e vërejtjes me shkrim të datës 04.01.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, neni 7, paragrafi 1.3, të Rregullores 04/2011, për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se; **Vërejte me shkrim dhe mbishkrim në dosjen personale të nëpunësit civil shqiptohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit përkatës.**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Drejtori i Drejtorisë Qendrore, me datën 03.01.2019, për mes e-mailit drejtuar Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, ka njoftuar se në bazë të njoftimit të datës 03.01.2019, nga asistentja znj, Abdullahu, ankuesi ka bërë fotografimin e dokumentacioneve zyrtare, librin e protokollit pa autorizim, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi, me këtë veprim ka bërë shkelje të detyrave të punës.



Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se nëpunësja civil me veprimet e sajë ka vepruar në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 1,2,3,4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës thuhet se: *“Në ushtrimin e Funksioneve të tyre, nëpunësi civil duhet të përkushtohet në zbatimin e ligjshmërisë dhe mbrojtjen e interesit publik dhe jo në realizimin e fitimeve personale apo për individët apo organizatat të tjera, nëpunësi civil nuk do të bëjë veprime apo të marrin vendime të cilat i tejkalojnë kufijtë e rangut dhe funksioneve të tyre, përveç atyre të përcaktuara me këtë ligj nëpunësit civil mund të ushtrojnë kompetenca diskreionale, në zbatimin dhe interpretimin e ligjeve dhe rregulloreve, në kuadër të kufjeve të përcaktuara shprehimisht me ato ligje dhe rregullore. Nëpunësit civil nuk duhet të shfrytëzoj, për çfarëdo qëllimi pozitën e tyre si përfaqësues të Autoritetit publik për të detyruar apo për të kërkuar nga palët e treta ose koleget dhe personelin të cilin e mbikëqyrin që të kryejnë pune, të bëjnë lëshime ose të marrin masa të jashtëligjshme ose të përbejnë vepër penale”*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Agjencisë Pyjore të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit 729, të datës 28.02.2019 ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me ankesën e ankuesit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr.229/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshtref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Gjykatës Themelore në Prishtinë Gjyqtarit Hajriz Hoti
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së